



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 90 e 91 të Ligjit Nr. 04/ L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera , nenit 8 paragrafi 2, pika 2 nenit 10 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM
PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR VLERËSIMIN E
DËMEVE

Neni 1

Me këtë Vendim, formohet, Komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të mëdha në Komunën e Lipjanit ka këtë përbërje;

1. Haqif Rrustemi - DMSH, kryesues
2. Milazim Miftar - DBP, anëtar
3. Gafurr Hetemi, - Zyra e Kryetarit, anëtar
4. Rrahman Olluri - DSHP, anëtar
5. Pajtim Krasniqi - DI, anëtar

Neni 2

Komisioni nga pika I e këtij Vendimi, në pajtim me nenin 9 të Rregullores 17/2015 emërohet për periudhën 4 vjeçare, përfshirë edhe sekretarin e komisionit.

Neni 3

Sekretarin e Komisionit komunal e cakton Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 4

Detyrat e komisionit janë përcaktuar me nenin 12 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 si dhe nenet tjera të cilat kanë të bëjnë me detyrat dhe përgjegjësitë e komisioneve komunal për vlerësimin e dëmeve.

Neni 5

Kompensimi për anëtarët e Komisionit komunal dhe komisioneve profesionale të themeluara sipas paragrafit 1 të nenit 12 bëhet në bazë të paragrafit 3 të nenit 10 të Rregullores (QRK) 17/2015 .

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit

1Nr. 325 -

Lipjan, më 12.01.2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

